

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2007

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke njohur dhe mbështetur rëndësinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për forcimin e demokracisë në Shqipëri, si institucioni kushtetues, i cili merret me përgatitjen, mbikëqyrjen, kontrollin, verifikimin e procesit zgjedhor, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve;

- duke vlerësuar domosdoshmërinë e përmirësimit të funksionimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

- duke mbajtur në konsideratë rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare për kontributin e këtij institucioni në arritjen e standardeve për zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike,

Konstaton se:

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vitin 2007 ka përmbushur detyrat e tij sipas Kodit Zgjedhor, në kushte të vështira, të krijuara si rezultat i tejkalimit të afateve ligjore zgjedhore, për shkak të vonesave që solli miratimi i ndryshimeve në Kodin Zgjedhor dhe zbatimi i tij nga subjektet zgjedhore;

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kryer detyrën e tij ligjore për zhvillimin e zgjedhjeve vendore të vitit 2007, me gjithë ndërhyrjet e forcave politike;

- transparenca për zgjedhjet e vitit 2007 ka qenë e plotë;

- ka mbajtur marrëdhënie të mira bashkëpunimi me institucionet shtetërore, partitë politike, institucionet ndërkombëtare dhe median;

- ka përdorur me efikasitet fondet e akorduara nga Buxheti i Shtetit për procesin zgjedhor.

Kuvendi kërkon nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vitin 2008:

- respektimin e Kushtetutës, të legjislacionit zgjedhor dhe të rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë në të gjithë veprimtarinë e këtij institucioni;

- analizë të thellë dhe të plotë të të gjitha problematikave që sjellin proceset zgjedhore, për të identifikuar mangësitë ligjore dhe të infrastrukturës;

- fillimin e punës paraprake për përgatitjen e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2009;

- vazhdimin e trajnimit dhe aftësimit të vijueshëm profesional të administratës zgjedhore;

- krijimin e një klime të përshtatshme bashkëpunimi e mirëkuptimi për zhvillimin e një procesi zgjedhor të lirë, të drejtë e të ligjshëm;

- ndërgjegjësimin e zgjedhësve për ushtrimin e së drejtës së tyre kushtetuese, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare.

17 prill 2008